

*"Merrni Shpirtin Shenjt!
Atyre që jua falni mëkatet,
u falen,
e atyre që nuk jua falni,
nuk u falen."*

(UNGJILLI I GJONIT 20,23)



Kisha dhe Jeta

ORGAN I PËRMUAJSHËM INFORMACIONI I METROPOLISË TIRANË-DURRËS Nr. 5 MAJ 2016 Çmimi 30 lekë



MERRE DHURATËN E SHPIRTIT TË SHENJTË

Krezmimet në Katedralen e Shën Palit në Tiranë

Kalendari Liturgjik

Qershor 2016

Kungimi dhe Krezmimi në
Katedralen e shën Plalit në
Tiranë

faqe 3

Deklaratë për Reformën
në Drejtësi

faqe 4

“Jezusi është i
mirëkupueshëm me mëkatarët;
po e vërteta nuk shitet kurrë”

faqe 4

Unë besoj në Perëndinë,
shkenca e besimi përputhen

faqe 5

Funerali i
Imzot Lucjan Avgustini

faqe 6-9

Bashkudhëtar shtegtimi
për vitin e mëshirës 2015-16

Nga Kardinal Vincent NICHOLS

faqe 9

Sakramendi i rrëfimit
20 arsye, për mos me
shku me u rrëfy!!!

Nga Dom Marjan LUMÇI

faqe 10-11

Jeta e një të burgosuri
nën dritëhijen e Udhës
së Kryqit

Nga M. Rr

faqe 12

Zemra e Krishtit

Lumturitë

Jezusi, kur pa turmën, u ngjit në mal. Kur
u ul, iu afruan nxënësit e tij. ² Atëherë mori
fjalën dhe i mësoi duke thënë:

“Lum skamnoret në shpirt
sepse e tyre është Mbretëria e qiejve!

Lumë ata që qajnë
sepse do të ngushëllohen!

Lum ata që janë të butë
sepse do ta trashëgojnë tokën!

Lum ata që kanë uri e etje për drejtësi
sepse do të ngihen!

Lum të mëshirshmit
sepse do të gjejnë mëshirë!

Lum ata që janë të pastër në zemër
sepse do ta shohin Hyjin.

Lum pajtuesit

sepse do të quhen bijtë e Hyjit.

Lum ata që salvohen pse kryejnë çka Hyji
kërkon

sepse e tyre është Mbretëria e qiejve.



Të lumët ju kur t'ju shajnë e t'ju salvojnë dhe
kur, për shkak timin, t'i thonë të gjitha të zezat
kundër jush, por në rrenë! Gëzohuni e galdoni,
sepse i madh do të jetë shpërblimi juaj në qiell!
Jo po, kështu i salvuan edhe profetët para jush!”

01 qershor – Sh. Justini

02 qershor – Sh. Marcelini dhe Pjetri

03 qershor – ZEMRA E SHJETE E JEZUSIT (C), Sh. Karl Lwanga dhe shokët

04 qershor – Zemra e papërlyeme e Shën Marisë Virgjër, Sh. Kuirini

05 qershor – E DIELA e X GJATË VITIT, Sh. Bonifaci

06 qershor – Sh. Noberti

09 qershor – Sh. Efremit

11 qershor – Sh. Barnaba

12 qershor – E DIELA e XI GJATË VITIT (C)

13 qershor – Shna Ndou i Padovës

17 qershor – Sh. Izauri, Inocenti, Feliksi, Hermi, Pelegrini e Bazili

19 qershor – E DIELA e XII GJATË VITIT,

21 qershor – Sh. Luigj Gonazaga

22 qershor – Sh. Niketa; Gjoni F. ; Tomë M. ; Paulini

24 qershor – LINDJA E SH. GJON PAGËZUESIT

26 1ershor – E DIELA e XIII GJATË VITIT

27 qershor – Sh. Çirili i Aleksandrisë

28 qershor – Sh. Ireneu

29 qershor – Sh. PJETRI DHE SHEN PALI (E Kremte)

30 qershor – Sh. Martirët e parë të Romës



Drejtore i përgjithshëm:

Imzot George Frendo

Kryeredaktor:

D. Marjan Lumçi

Sekretar:

Ferdinand Ndoca

Redaksia:

Kolec Çefa
Ana Stakaj
Zef Skanjeti
Elidon Dodaj

Grafika:

Pjerin Sheldija
Foto: Pici

Adresa:

Katedralja e Shën Palit,
Bulevardi Zhan D'Ark,
Tiranë, Shqipëri

E-mail: kisha.jeta@gmail.com

www.kishadhejeta.com

Kungimi e Krezmimi sipas këshillave të Françeskut

Kungimi dhe Krezmimi në Katedralen e shën Plalit në Tiranë

Muaji i majit sëbashku me aromën e lulëzimit pranveror solli edhe aromën e këndshme të sakramenteve të Kungimit të Parë e të Krezmimit, që i dhanë Katedrales së “Shën Palit” frymëmarrjen rinore e entuziazmin e katekumenëve, të cilët për një vit rresht kryen përgatitjen e katekizmit. Në praninë familjarëve, motrave e vëllezërve, nënave e baballarëve, por edhe duke qenë shpirtërisht pranë lutjes së besimtarëve që i shoqëruan me datat 8 dhe 15 maj, respektivisht rreth 50 katekumenë iu afruan Kungimit të Parë ndërsa 80 katekumenë morën sakramentin e Krezmimit. Katedralja, në këto dy të djela, me ngjyrat festive dhe e mbushur plot e përplot, përjetoi çate me të vërtetë të mrekullueshme. Në të dyja rastet, duke reflektuar mbi aktualitetin dhe vështirësitë e jetës në raport me përjetimet dhe besimin në shpirtin e besimtarit, fjalët e Mons. George Frendos u kthyen në një ftesë për t’iu përgjigjur me zemër të hapur Krishtit. Monsinjori, duke u kujtuar katekumenëve zbritjen e Shpirtit Shenjt mbi apostujt dhe mbushjen e tyre me besimin në Jezun Krishtin, uroi që edhe mbi ta Shpirti Shenjt të japë sigurinë, urtësinë e fuqinë për të përballuar vështirësitë që jeta vë përpara, por mbi të gjitha uroi që t’u japë frytet më të mira të besimit.

Sikurse katekumenët e këtij maji të 2016-ës, në katedralen e Shën Palit, Papa Françesku kungimin e parë dhe krezmimin, i ka marrë në të njëjtën ditë e si kreu i Kishës duke u përqsaur në kujtimet e veta, shpesh me ngrohtësi jep porosi mjaft të vyera që fëmijët ta analizojnë në drejtpeshim të plotë këtë çast domethënës të jetës së besimtarit. Para pak kohësh, për këtë, Papa kujton:

«Ishte 8 tetori i 1944 dhe unë nuk mund ta harroj atë ditë! Kujtojeni gjithnjë edhe ju, për tërë jetën tuaj, atë ditë kur për herë të parë Jezusi vjen ndër ne. Ai jeton e bëhet njeri prej nesh, bëhet ushqimi ynë, bëhet buka jonë për të na dhënë forcën», ka thënë Papa duke pasur parasysh rëndësinë që ka ky çast i kurorëzimit të përgatitjes intensive katekistike.



Ndërsa duke folur për Krezmimin, me të cilin ripërtërihen premtimet e bëra nga Pagëzimi, Papa vë theksin mbi veprimin e marrëdhënien konstante me Shpirtin Shenjt: «T’ia hapin derën Shpirtit Shenjt e ta lemë veten të udhëhiqemi prej Tij. Vështirësitë apo mundimet që janë pjesë e rrugës për të arritur lavdinë e Perendisë, do t’i hasim gjithnjë në jetë. Kurrë të mos shkurajohemi! Kemi forcën e Shpirtit Shenjt për të ngallnjyer mbi mundimet e torturat që mund të ketë jeta». E për më tepër, Papa shton: «Ne të krishterët nuk jemi zgjedhur nga Zoti për gjëra të vogla, prandaj shkoni gjithmonë përtej, drejt gjërave të mëdha. Vendoseni jetën tuaj në lojë për ideat e mëdha!».

Me transparencë Papa Françesku porositi: «Ne kurrë nuk e falenderojmë sa ç’duhet Zotin për dhuratën që na e ka bërë me Eukaristinë! Kjo bukë e cila është Korpi i Jezut Krishtit e që na shëlbën, na fal e na bashkon me Atin; dhe ne kurrë nuk do të mbarojmë së marri të gjithë vlerën dhe pasurinë».

Është e gjitha kjo, platforma që u duhet transmetuar fëmijve dhe çka fëmija duhet ta

kuptojë siç duhet, duke e vendosur veten në qendër të asaj pune aq të çmuar e me vullnet të pastër të katekistëve – atyreve që shoqërojnë kandidatin në shtegun drejt sakramentit, duke i përçarur të gjithë entuziazmin e shpirtit të vet. Kjo, e çon fëmijnë në derën e rrëfyesorit me mendjen e hapur e me kurajën dhe forcën që jep vetëm besimi në Krishtin. Sigurisht mbetet t’i përforcohet fëmijve, se sikurse është shprehur Papa Françesku, rrëfyesi nuk është një “dyqan bojrash” në të cilin u hiqen njollat një palë rrobave që mund të bëhen pis përsëri, por është një vend në të cilin Zoti na pret për të na e dhënë faljen që buron prej mëshirës së tij të pakufishme.

Ky ishte mendimi i Atit Shenjt, që na çon madje edhe deri tek gëzimi e festiviteti që merr formë e gjallërohet (nganjëherë në ekzagjerime) në shenjat e në përgatitjen e gjithanshme të gostisë me familjet e me shokët tanë, ku Papa tërheq vëmendjen se dita e Kungimit të parë dhe e Krezmimit është dita që nuk duhet të harrojmë se festa e vërtetë është ajo që është brenda zemrave tona.





CONFERENTIA EPISCOPALIS ALBANIAE KONFERENCA IPESHKVORE E SHQIPËRISË

Tiranë, më 11 maj 2016

Deklaratë për Reformën në Drejtësi

Konferenca Ipeshkvore e Shqipërisë, e mbledhur në Asamblenë e saj të zakonshme, në datat 10 -11 maj 2016, ndër të tjera ka diskutuar edhe për Reformën në Drejtësi që pritet të bëhet në vendin tonë.

Drejtësia është një nevojë e brendshme e njeriut, si individ dhe si shoqëri. *Një shoqëri e drejtë është një e drejtë për të gjithë.* Kisha katolike dhe të krishterët katolikë jetojnë në shoqërinë shqiptare dhe janë pjesë e gjallë e saj, prandaj ne si barinj kemi për zemër çdo çështje që ka të bëjë me mirëqenien e grigjës që na është besuar, por edhe të vendit në përgjithësi.

Për këtë arsye, ne si barinj të Kishës katolike, inkurajojmë institucionet përkatëse, përfaqësuesit e popullit në parlament, partitë politike dhe të gjithë punonjësit e drejtësisë, që të angazhohen fuqishëm në këtë reformë dhe ajo të zbatohet sa më mirë dhe sa më shpejt. *Drejtësia e vonuar është gjithmonë drejtësi e mohuar* – thotë një rregull e lashtë e së drejtës. Pa vonesa, por me kompetencë dhe vendosmëri, Reforma në Drejtësi duhet të realizohet dhe të jetë sa me efektshme.

Ndër shumë apekte të kësaj reforme do të donim të veçonim dy prej tyre që ne i shohim si të rëndësishme dhe jetësore për vendin dhe demokracinë.

Së pari kjo Reformë duhet të garantojë që, ato apo ata, të cilët do të përfaqësojnë popullin si të zgjedhur, apo që do të shërbejnë si të emëruar, të jenë *figura të pastra nga precedentë kriminalë apo afera korruptive.* Nevoja e njerëzve të përkushtuar dhe që shërbejnë pa interesa të dyta apo për të mbuluar të kaluarën e tyre, është një hap i rëndësishëm në ndërtimin e shoqërisë dhe sidomos në fuqizimin e organeve përfaqësuese në të treja pushtetet që njeh demokracia: *legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori.* Është jetike për vendin dhe për kuptimin e drejtësisë që kush punon në këto organe të ketë një sens përgjegjësie dhe drejtësie të spikatur e plot me pasion, përveçse të jetë një figurë e papërlyer nga barra e korrupsionit dhe kriminalitetit.

Së dyti dëshirojmë të vendosim theksin në ndryshimet kushtetuese që kanë të bëjnë me ligjiin e mos-diskriminimit (Neni 4). Kisha katolike mbështet nismat për mos-diskriminimin dhe reflektimi i saj nxitet nga kujdesi për çdo lloj situatë njerëzore që kërkon delikatesë dhe tutelë. Në këtë prizëm, edhe në Kishën katolike, ka një reflektim që shkon në drejtim të përkujdesjes dhe mosdiskriminimit në të gjitha dimensionet e jetës njerëzore. Nga ana tjetër ne kërkojmë nga ligjvënësit që këto ndryshime, në një të nesërme,

të mos prekin kodin dhe sensin e familjes, që për ne të krishterët është ajo e themeluar mbi martesën ndërmjet një burri dhe një gruaje. Ashtu e ka theksuar edhe Papa Françesku në dokumentin e tij të fundit *Amoris Laetitia* duke thënë shprehimisht: “...vetëm bashkimi ekskluziv ndërmjet një burri dhe një gruaje kryen një funksion shoqëror të plotë, duke qenë se është një angazhim i qëndrueshëm që bën të mundur vazhdimësinë e jetës. Duhet të pranojmë larminë e madhe të situatave familiare që mund të ofrojnë një farë rregulli jete, por çiftet bashkëjetuese apo bashkëjetesat e personave me të njëjtën gjini ... nuk mund të barazohen aq lehtësisht me martesën. Asnjë bashkim i paplotë apo i mbyllur ndaj vazhdimësisë së jetës nuk mund të na sigurojë të ardhmen e shoqërisë”. (AL 52)

Së fundmi urojmë dhe lutemi që Reforma në Drejtësi të gjejë binarët e duhur si dhe vullnetin e palëve për t’u realizuar. Kjo është një përgjegjësi e madhe para njerëzve të cilët kanë të drejtën ta shohin të përmbushur këtë reformë e cila ka mbështetjen tonë dhe të gjithë partnerëve e miqve tanë ndërkombëtarë.

Ipeshkëvinjtë Katolikë të Shqipërisë

“Jezusi është i mirëkuptueshëm me mëkatarët; po e vërteta nuk shitet kurrë”



Martesa e pandashme

“Jezusi u çua prej andej e shkoi në krahinë e Judesë, përtej Jordanit. Përsëri përrreth tij u mblodhën një turmë e madhe populli dhe ai sërish nisi t’i mësojë siç e kishte zakon. Atëherë

iu afruan farisenjtë, e për ta sprovuar, e pyetën:

“A ka leje burri ta lëshojë gruan?”

Ai u përgjigj:

“Çka ju urdhëroi Moisiu?”

Ata iu përgjigjën:

“Moisiu lejoi *të shkruhet letra e divorcit e të lëshohet.*”

Jezusi u tha:

“Atë rregullore Moisiu e shkroi për ju për arsye të kryeneçësisë suaj. Por në fillim të botës, Hyji *i krijoi mashkull e femër. Prandaj njeriu do ta lërë babën e vet e nënën e vet e do të bashkohet me gruan, e kështu të dy do të jenë një trup i vetëm.* Këndeji pra, nuk janë më dy, - por një trup i vetëm. Prandaj, çka bashkoi Hyji, njeriu të mos guxojë të ndajë!”

Në shtëpi nxënësit e pyetën përsëri për të njëjtën gjë. Ai u tha:

“Kush e lëshon gruan e vet e merr një tjetër, bën kurorëthyerje kundër së parës. Po qe se edhe grua e lëshon burrin e vet e martohet me një tjetër, bën kurorëthyerje.”

Dashuria gjithmonë duhet të shkojë dora-doraz me të vërtetën dhe anasjelltas. Këtë gjë, papa Françesku e ka theksuar edhe gjatë një omelie të periudhës së fundit në Shtëpinë e Shën Martës, duke marrë nxitjen nga fragmenti i Ungjillit të ditës (Mc 10, 1-12), në të cilin Jezusi diskuton me farisenjtë, lidhur me kurorëthyerjen, të gjykuar sipas “kasistikës (rastet studimore apo

teorike) nga ana e “grupit të vogël të teologëve të ndriçuar (apo të shkolluar)”,

Jezusi i bëjnë pyetjen nëse është e lejueshme që burri ta ndajë gruan e vet, por ai arrin t'i shmangët të gjitha kurtheve duke qenë i bindur se e kishte bagazhin e “të gjithë shkencës dhe të zgjuarsisë së popullit të Zotit”.

Tashmë, Jezusi i qe përgjigjur me përparësi saduçejeve, duke iu referuar kështu gruas e cila kishte shtatë raste bashkëshortësh; këtu ai bën me dije, se në çastin e Ringjalljes, gruaja nuk martohet me askënd prej tyre, pasi në qiell nuk mund të merret “as gruaja e as burri”. Ndërkohë, që në këtë rast të fundit, Jezusi i referohet normave “të përmbushjes martesore”, me farizejtë “shkon drejt plotësisë së harmonisë së krijimit”, apo në dritën e Zanafillës: “Perëndia krijoi burrin e gruan” dhe “të dy do të jenë një trup i vetëm”.

Me fjalë të tjera, Jezusi kujton se: “njeriu nuk mund të ndajë atë çka Perëndia e ka lidhur”. Ndryshimi me “teologët e ndriçuar”, konsiston në faktin se “Jezusi kurrë nuk e negocion të

vërtetën”, ndërsa ata e “negociojnë”, duke e reduktuar atë tek “kasistika”.

Mbetet fakti se “Jezusi është shumë i mëshirshëm; e është aq i madh në mëshirë, sa kurrë, kurrë dhe kurrë nuk ua mbyll derën mëkatarëve”. Në të njëjtën kohë, nuk kufizohet vetëm me lajmërimin e së vërtetës, por fton farisejtë që ta përforcojnë atë çfarë Moisiu e kishte vendosur në ligj: u përgjigjet atyre se, kundër kurorëthyerjes i drejti jo vetëm “hedh poshtë”, por edhe kundëreplikon pasi kjo normë është “e shkruar” edhe për “ngurtësinë e zemrës”. Jezusi ka dashur të dallojë mirë mes së vërtetës dhe “dobësisë njerëzore”, pa bërë së tepërmi “kthimet apo shtrembërimet e frazës”.

Në ditët e sotme, në një botë të ndikuar nga “kultura e provizores”, realiteti i mëkatit është “shumë i fortë”, nënvizon Papa, megjithatë është gjithmonë Jezusi që na kujton për “ngurtësinë e zemrës”, pasi mund t'i kundërvemë “faljen, mirëkuptimin, shoqërimin, integrimin dhe shoshitjen këtyre rasteve”, duke qëndruar të

patundur në atë se “e vërteta nuk shitet kurrë”.

Po ashtu, “Jezusi është i aftë të thotë se kjo e vërtetë është aq e madhe sa që në të njëjtën kohë duhet të jesh i mirëkuptueshëm me mëkatarët, me të dobët”, ka shtuar Ati Shenjtë.

“E Vërteta e mirëkuptimi” janë dy realitete që, të vendosura sëbashku, i largohen logjikës së “teologëve të ndriçuar”, që e redukojnë gjithçka në “ekuacion matematik”: “mundet/nuk mundet”; pra ata janë “të paaftë si në horizontet e mëdha ashtu edhe në aspektin e dashurisë”. Me Jezusin gjithçka ndodh ndryshe: me “delikatesë”, ai i thotë gruas kurorëthyerse: “As unë nuk po të dënoj; shko e tani e tutje mos mëkato më”.

Lutja përfundimtare bëhet për arsyen që “Jezusi të na mësojë të përqasemi me më shumë zemër të hapur ndaj së vërtetës e madje ta shprehim më shumë mirëkuptimin tonë në drejtim të shoqërimit të të gjithë vëllezërve që janë në vështirësi”, duke evituar “kufizimet e ekuacionit të kasistikës ndaj marrëdhënies që na vë përpara plotësia e Perëndisë”.

Unë besoj në Perëndinë, shkenca e besimi përputhen

Drejtoresha e “Cern të Gjenevës” thotë besoj në perëndinë, pasi e shoh se shkenca dhe besimi janë kompatibël


Italia Fabiola Gianotti është drejtoreshë e përgjithshme e laboratorit më të madh të fizikës së shpërbërjes molekulare në botë, duke pasur kontribut në zbulimin e **boson-it të Higgs** (“thërmija e Perëndisë”)

Nga UCCR

Nga 1 janar 2016 italia Fabiola Gianotti është drejtoresha e përgjithshme e “CERN të Gjenevës”, i cili është laboratorit më i madh në botë, në aspektin e fizikës së shpërbërjes së thërmijave molekulare. Ajo ka një rol, sigurisht të merituar, edhe në kontributin e madh drejt zbulimit të **bosonit të Higgs**.

ZONJA E SHKENCËS

Gianotti, e përcaktuar “zonja e shkencës”, padyshim është mes shkencëtarëve më në zë në botën e sotme. Më 6 janarin e kaluar ajo ka qenë e ftuar në transmetimin “Otto e mezzo (tetë e gjysëm)”, të drejtuar nga “shkatërrimtarja” Lilli Gruber. Në lidhjen nga Gjeneva, Gianotti u është përgjigjur shumë pyetjeve mbi fizikën molekulare, si punë kërkimore mbi raportin mes shkencës dhe besimit: «shkenca dhe religjoni duhet të qëndrojnë mbi dy rrugë të ndara», është përgjigjur Gianotti: «shkenca bazohet



mbi demonstrimin eksperimental dhe religjoni bazohet mbi parime plotësisht të kundërta, e pra në lidhje me besimin, është më tepër i merituar ai që beson pa pasur shikuar me sytë e veta. E shkenca nuk mundet kurrë ta demonstrojë ekzistencën ose mosekzistencën e Perëndisë».

Ndaj pyetjes së Gruber-it nëse beson në Perëndinë, shkencëtarja e famshme i është përgjigjur në mënyrë të prerë: «Po, unë beoj». Intervistuesja pra, ka bërë pyetjen: a është shkenca kompatibël me besimin? «Absolutisht që po, nuk ka kundërshti. E rëndësishme është t'i lësh këto dy plane të ndara: të qenit besimtar ose të qenit jobesimtar; dhe nuk është këtu fizika, ajo që na e jep përgjigjen».

ASNJË KONTRADIKTË MES SHKENCËS DHE BESIMIT

Edhe pak ditë më parë, në një intervistë në “Repubblica”, shkencëtarja kishte thënë: «Shkenca e religjoni janë disiplina të ndara,

ndonëse jo antitetike (armiqësore). Mund të jesh fizikant e të kesh besim ose jo. Është më mirë që Perëndia e shkenca ta ruajnë distancën e duhur». Të njëjtin koncept e kishte riafirmuar në “Famiglia Cristiana” të 2010-ës: «Nuk shikoj asnjë kontraditë mes shkencës dhe besimit: u përkasin dy sferave të ndryshme. Do të tregoheshim tepër ambiciozë e tepër arrogantë nëse do të mund të mendonim të shpegonim origjinën e botës. Ajo çfarë mund të bëjmë ne shkencëtarët është që të shkojmë përpara hap pas hapi dhe të grumbullojmë përvojën. Por, siç thonte Newton, ajo që ne dimë është një pikë e vogël uji ndërkohë që ajo çfarë nuk dimë është një oqean, d.m.th. jemi mjaft larg përgjigjes për pyetjet e këtij lloji».

ASGJË E PAZAKONTË

Asgjë e pazakontë, me sa duket, përvoja e besimit të Giannotti-it, nuk vlen as më shumë dhe as më pak se ajo e një meshtari, e një muratori apo e një librashitësi. E, mbitëgjitha, nuk është veçse një prej mijëra shkencëtarëve për ta menduar kështu. [...]

Sigurisht, do të jetë një goditje e madhe për Piergiorgio Odifreddi e për ndjekësit e tij, gjithmonë të zotuar për të dhunuar shkencën që përpiqet të demonstrojë ekzistencën e Perëndisë apo më thjesht, për të akuzuar besimtarët për injorancë o marrëzi. Përtej dëmit tallja: ndërsa Gianotti është në krye të Cern-it, Odifreddi nuk e duan as edhe si president të Jurisë së “Letterati” të “Campiello 2015”. Nuk ekziston më iredigjoni, as edhe mes shkencëtarëve.

Imzot Lucjan Avgustini pushon në shtëpinë e Atit



Në të kremten e Trinisë Shenjte, me datë 22.05.2016, pas një sëmundjeje të rëndë e pakthim, me dhimbje të madhe, Ipeshkvia e Sapës njoftoi se në orën 15:15, në praninë e klerikëve të dioqezës si dhe të njerëzve të tij të familjes, pushoi së rrahuri zemra ende e re e Imzot Lucjan Avgustinit. Ai, iu drejtua paqes së amëshimit hyjnor të Atit në moshën 53 vjeçare, duke na lënë kujtimin e prelatit të përkushtuar, që për Jezu Krishtin nuk kursen asgjë e është në gjëndje të bëjë gjithçka.

Po atë mbrëmje, rreth orës 20.00, trupi i të ndjerit u vendos për homazhe në elterin e Katedrales së "Nënë Terezës". Atmosfera e

lutjes dhe homazhet nuk reshtën për tre ditë rresht, deri të mërkurën e 25 majit, në orën 10.00 të paraditës kur u kremtua Mesha e Salikimit që u ndoq nga vendosja e trupit në kriptën e katedrales.

Mons. Avgustini, do të mbetet në kujtesën e grigjës së vet por edhe të gjithë atyreve që patën rastin ta takojnë në jetë. Duke na lënë si shenjë jo vetëm praninë e tij trupore në Katedralen e "Nënë Terezës", por edhe mirësinë e kryebariut të dioqezës, ku me aq dashuri ushtroi shërbesat dhe funksionet e shenjta të prelatit të zgjedhur, lutemi për të: "E lehtë të qoftë toka e pushim të amshuar në Paqen e Krishtit!"

Lamtumirë Imzot Lucjan Avgustini

Pas tre ditë homazhesh, të mërkurë e datës 25 maj 2016, Ipeshkvia e Sapës, i dha lamtumirën e fundit bariut të saj, Imzot Lucjan Avgustinit, i cili kaloi në amshim në moshën 53 vjeçare, pas një sëmundjeje të rëndë. Mesha e dritës u mbajt në Katedralen Nënë Tereza në Vau-Dejës, udhëhequr nga Kryetari i Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë, Imzot Angelo Massafra. Përveç popullit të Zotit që kishte stërmbushur Katedralen dhe ambjentet e jashtme të saj, nderuan me praninë e tyre, Nunci Apostolik në Shqipëri, Imzot Romiro Moliner Ingles, e gjithë hierarkia e Kishës Katolike në Shqipëri, Meshtarët dhe Motrat e nderit të Shqipërisë, Kosovës dhe Malit të Zi.

Gjithashtu në këtë përcjellje të fundit, nderuan Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Bujar Nishani, ish kryeministri, z. Sali Berisha, Krerë të institucioneve të larta shtetërore, diplomatike edhe krerët e besimeve të tjera fetare.

Në predikimin e rastit, Imzot Dodë Gjergji, ipeshkvi i Kosovës e njëkohësisht shoku i jetës së tij dhe vëllau në Krishtin, theksoj se ndërsa i japim lamtumirën e fundit, shumë të dashurit dhe kurrë të paharruarit, ipeshkvit të Sapës, pinjollit të familjes Avgustini, mikut tonë, Imzot Lucjan Avgustinit, të cilin Zoti desh ta thërrasë te vetja, dhe ndërsa jemi të trishtuar e pranojmë vullnesën e Zotit, jam shumë i bindur se, ai gëzon në lumturinë e qiellit paqen dhe lumturinë e amshuar. Hyji e paska përgatitë për amshim; vullneti i Tij paska qenë që ta lartësojë në fronin e shenjtërve dhe në shoqërinë e ëngjëjve të vet. Mes emocioneve të shumta, Imzot Doda e mbylli homelinë e tij duke iu

drejtuar Imzot Lucjanit: **"Vëlla i dashtun do të them të vërteten sikur kam ba gjithmonë. Kam marrë kryqin tand te krabarorit e ty te kam lanë kryqin tem. Ne kete mënyrë, një pjesë e imja do te vdesë me ty e do të jetë me ty, e një pjesë e jotja do të jetojë gjithmonë me mua"**

Vikari Gjeneral i Sapës Dom Simon Kulli, që pati fatin të ndante 10 vite të jetës së tij, shpalosi fjalët e dalura prej zemrës për figurën e ndritur dhe të lavdishme të Atit shpirtëror dhe bariut të kësaj grigje, duke theksuar se **"Kisha humbi një Bari, Kombi humbi një zë, familjarët humbën një bir dhe vëlla, dioqezat jonë e Sapës humbi një prind, një babë. Por në qiell, jemi të sigurtë se kemi një ndërmjetësues të vazhdueshëm"**.

Në këto momente vuajtje dhe pikëllimi, edhe Ati i Shenjtë Papa Françesku shprehu afërsinë e tij shpirtërore me familjarët, me presbiterin dhe me të gjithë besimtarët nëpërmjet një mesazhi ngushëllues, në të cilin thuhet: **"Duke kujtuar shërbesën kishtarë bujare të bariut të denjë, Shenjtëria e Tij i lutet Zotit për shpërbelimin e amshuar që u është premtuar shërbëtorëve besnikë të Ungjillit dhe i kërkon së lumes Virgjër**



Mari të ndërmjetësojë për të marrë prej Zotit ngushëllimin e krishterë për të gjithë ata që qajnë Ipeshkvin e ndjerë. Me këto ndjenja, Ati i Shenjtë i jep nga zemra mbarë bashkësisë dioqezane bekimin Apostolik.

Bashkë me dhimbjen, kleri dhe gjithë asambleja kishtarë lartësuan lutjet kah Zoti duke shoqëruar trupin e pa jetë të Imzot Lucjanit për në banesën e fundit, në kriptën e Katedrales së Nënë Terezës. Pushofsh në Paqe Bariu ynë!

Violeta Marashi

Predikimi i ipeshkvit të Kosovës, Imzot Dodë Gjergjit, në Meshën e Dritës së Ipeshkëvit të Sapës, Imzot Lucjan Avgustinit

*Fort të dashur Vëllezër në Episkopat dhe meshtari,
Të dashur rregulltarë e rregulltare, seminaristë
e kandidate,*

Të dashur motra dhe vëllezër në Pagëzim

Shumë e nderuara familje Avgustini,

E nderuar Dioqezë e Sapës, Ju grigjë e përkryer,

Me ju dhe në emrin tuaj, dëshiroj të falënderoj Presidentin e Shqipërisë, të gjithë autoritetet shtetërore e politike, përfaqësuesit e komuniteteve fetare, pjesëtarët e korit diplomatik, por edhe të gjithë miqtë e dashamirët që sot bashkë me ne dëshirojnë t'i japin lamtumirën e fundit, shumë të dashurit dhe kurrë të paharruarit, Ipeshkvit të Sapës, pinjollit të familjes Avgustini, mikut tonë, Imzot Lucjan Avgustinit, të cilin Zoti deshi ta thërrasë te vetja, dhe jam shumë i bindur se, deri sa ne të trishtuar e pranojmë vullnesën e Zotit, ai gëzon në lumturinë e qiellit paqën dhe lumturinë e amshume.

Nuk e di, cilit prej jush, nuk do ti dridhej sot buza, po të detyrohet të flasë për këtë njeri kaq të mrekullueshëm? E, le ma mua, që më duhet t'i belbëzoj këto fjalë për mikun më të shtrenjtë të jetës sime, i cili na la, mu atëherë, kur pritnim më së shumti prej Tij. I lutem Hyjit që të më forcoj me qëndresën e pathyeshme të fesë. Edhe pse zemra na u nda përgjysmë, prapë do të dimë të përballojmë me fe trishtimin dhe me uratë dhimbje. Këndeji i lutem Zotit të më dhuroj duresën e Jobit, kur Zoti i mori gjithçka, atë qetësinë që i dha Davidit kur ia mori të birin, guximin e Marisë për të qëndruar nën Kryqin e Krishtit të Kryqëzuar. Po ashtu i lutem Hyjit, që të marrë një gacë nga zjarri i Shpirtit të Shenjtë të tij, e t'i djeg buzët e mija që t'ju flas goja ime në këtë moment kaq të dhimbshëm për të gjithë ne, sidomos për Kishën në Shqipëri, për dioqezën e Sapës, për familjen Avgustini dhe për gjithë popullin tonë kudo.

Ne të gjithë shpresonim që ky do të jetë e ardhmja e Kishës në Shqipëri. Shumëkush në mendimet e veta por edhe në përgjegjësitë që bartin, thurnim plane se ku, dhe si do të shfrytëzonim më mirë zellin e tij baritor, aftësitë e tij drejtuese dhe kapacitetet e tija shpirtërore. Në anën tjetër Kisha e Sapës, me xhelozin kujdesej që të tjerët t'mos ja marrin bariun, të cilin e donin shumë. Por, ja që rrugët e Zotit qenkan të pashqyrtueshme, vullneti i tij i pandryshueshëm dhe planet e tija të pakuptueshme.

Hyji e paska përgatitë atë për amshim, vullneti i Tij paska qenë që ta lartësojë në fronin e shenjtërve dhe në shoqërinë e engjëjve të vet. Kurse, si duket, neve t'gjitheve, me këtë humbje ka dashtë të na e"shkundë shpirtin", që gjërat t'i shohim me dritën e fesë. Kështu, në ditën e **Trinisë së Shenjtë**, Zoti përfundimisht e thirri te vetja duke e bashkuar atë me shenjtërit e Tij, me Nënë Terezën që do të shenjtërohet dhe me martirët që do të lumnohen.

Në uratën time i thashë Zotit. Po, a pak të dhamë?! Po, a nuk e ka mbushë kjo kishë qiellin me martir gjatë shekujve, e sidomos gjatë Diktaturës së

fundit? Dhe në shpirt dëgjova një përgjigje: po ju m'i dhatë sepse i vratë, por këtë dua ta marr unë.

E si ngjau e gjithë kjo?

1. Para tre muajve, u konstatua se Monsinjori Llluciani, mund të ketë një sëmundje të rëndë. Pasi u dha ky alarm u munduam të përdorim të gjithë mjetet që njeriu ka në dispozicion për ta shëruar, por shumë shpejt u konstatua se sëmundja e tij i tejkalonte mundësitë tona njerëzore dhe arritjet e mjekësisë. Mu në valën e përkjekjeve tona ai me çdo kusht, deshi të lente spitalin dhe të kthehej në dioqezë që për herë të fundit të kremtonte Pashkët me priftat e dioqezës së vet dhe me grigjën e tij. Ishte i lumtur për këtë gjë sepse thoshte: **"ishin këto Pashkët më të bukura që i kam kremtuar ndonjëherë"**.

2. Pas Pashkëve, përsëri u angazhuam t'ia zgjatnim sado pak jetën. Por mjerisht, mjekësia përsëri u dorëzua para sëmundjes së tij.

Në këtë situatë, u desht që të marrim vendimin më të dhimbshëm: atë që ta kthejmë në Dioqezë, në mënyrë që, të mos lëngoij nëpër spitalet e botës por, nëse duhej që të vdesë atëherë bariut i duhet të vdesë në **"prehnin e kishës së vet"** i rrethuar prej **"grigjës tij"**. Në këtë rast, lëshuam kushtimin që nëpërmjet lutjes t'ia kërkojmë Zotit një mrekulli.

Iu lutëm Zotit në të gjitha Kishat tona, nëpër shumë Kisha të vendeve të tjera të botës që e kanë njohur, por edhe aty ku kishte arritë jehona e dhimbjes, klithma e dashurisë e zëri i uratës tonë.

Kurse dioqeza e Sapës, dhe shumë që e kanë dashur, të bashkuar në uratë **nën dritaren e Bariut**, kalonte nëpër **luginën e trishtimit**, mes shpresës që Zoti do ta dëgjonte lutjen e tyre, dhe **dhimbjes për vuajtjet e bariut** që lëngonte në shtratin e vdekjes.

3. Në festën e **Trinisë së Shenjtë**, rreth orës tre të pasdites, në praninë e familjes së gjakut dhe asaj të shpirtit, Hyji që e kishte thirrë në Jetë, Krishti që e kishte thirrë në meshtarinë e Tij, Shpirti i Shenjtë që e ka Shuguruar tri herë, pagëzim, meshtar dhe ipeshkëv, si **Trini e Shenjtë**,

me një **zë trinitar**, përfundimisht vendosi ta thirrë shpirtin e tij te vetja. E ne, na mbeti vetëm trupi i tij, të cilën **pas kësaj meshe drite** për shpirtin e Monsinorit tonë të dashur, do ta varrosim e do t'ia dhurojmë tokës, që atje të pushojë në paqe, deri sa Ai që rri në Fronin e gjithësisë ti bëjë të reja të gjitha gjërat! «Zbu 21,5b dhe të fshijë çdo lot nga sytë tanë. Atëherë kur Vdekja më s'do të jetë, as vaj, as ofshamë, as dhimbje, sepse gjithçka do të shndërrohet në të re. (Krah. Zb 21, 4). Tani, per tani ç'mund të themi përveç se, "u bë siç dhe ti" O Zot! Ashtu edhe le të jetë.

Ne me fe e me bindje e pranojmë vullnetin e Hyjit, që u shfaq mbi Kishën e Krishtit, në personin e Imzot Lucjanit.

- **e pranojmë si njerëz, që dinë të bashkëndajnë të mirën dhe të keqen, gëzimin dhe hidhërimin, vuajtjet dhe hiet.**

- **si shqiptarë, sepse gjithnjë kemi ditë ta kthejmë vajin në këngë, sepse shumë gjatë "kemi vuajtur duke shpresuar dhe kemi shpresuar duke vuajtur, këndeji edhe jemi gjallë.**

- **e sidomos e pranojmë këtë vullnet si besimtarë, të cilët besojnë se vdekja nuk është fjala e fundit, ajo është e fundit vetëm sa i përket mëkatit, po jo sa i përket Hyjit. Fjala e fundit e Hyjit është ringjallja dhe jeta. Mu ashtu sikur na dëshmon edhe në pjesën e ungjillit që kemi lexuar: Unë jam ngjallja e vërteta dhe jeta. Kush beson në mua s'do të vdes kurrë. Ta lejojmë Krishtin Zot, që të na ngushëllojë edhe ne me të njëjtat fjalë feje që i ngushëllonte motrat e Lazrit. Sepse, për ne të krishterët që vdekjen tonë e bashkojmë me atë të Krishtit, të vdesësh do të thotë të shkosh i shoqëruar me të në amshim. (Krh.KKK Cap.12). Nuk ka, pra, tani kurrfarë dënimi ...Sepse, Ligji i Shpirtit Shenjt që na jep jetën në Jezu Krishtin, na çliroi nga ligji i mëkatit dhe i vdekjes. (Krh. Ron 1,1-2). Këndeji, me Shën Palin mund të dëshmoj se: "... të gjitha vuajtjet e tanishme nuk janë të denja të krahasohen me lumturinë e ardhshme që do të zbulohet në ne. (Krh. Ron 1,18) në saje të Atij që na ka dashur. Krh. Ron 8,37b)**



Fort të dashur,
më lejoni t'iu them edhe një fjalë Kishës së Sapës,
familjes Avgustini, dhe mikut tim të jetës që gjithnjë
e kam quajtur **"Zemo"**!

Kishë e Sapës, vazhdo të bashkohesh në lutje dhe
bëhu e fortë! Sepse, në kohën e re ju jeni përballë me
dhimbje të shpeshta: një herë Zoti mori Motër Marizën,
Don Antonin, pastaj don Gencin e tani po u merr
Bariun. Por ju do të dini të qëndroni të paluhatur
në fe. Të paluhatur, mu si Jobi. Ju deri tani jeni lute
për Ipeshkvin tuaj, tani mundeni lirisht t'i luteni atij,
që të ndërmjetësojë për ju. Ju s'do ta keni ma ipeshkëv
Lucjanin, por do të keni mësimin, dëshminë dhe
shembullin që ju ka lanë për trashëgimi.

E për ne të gjithë që e kemi dashur dhe e kemi
njohur, le t'ia plotësojmë dëshirën e zemrës së tij
sikur e ka përsërit shpeshherë: **"Që të realizohet
një pajtim i gjithëmbarshtëm, që të pajtohen të
gjithë dhe të pajtohen deri në fund"**. Por edhe
atë porosi të fundit që ua la për Pashkë: **"Duajeni
shumë njëri-tjetrin"**!

Familje e dashur Avgustini, Ju motra dhe
vëllezër të Monsinjonit tonë të dashur, e di që e keni
zemrën e thyer dhe që tani me vdekjen e ma të mirit,
ndër ju, jeni të tronditur dhe të mërzhitur shumë, por,
Zotin dhe uratën e gjithë këtyre njerëzve e paqi në

ndihmë në këtë sprovë të madhe për ju. Ju ia keni
dhuruar Zotit një vëlla, një axhë, një dajë. Ai jetën e
tij, kushtuar Zotit. Ju duhet të ngushëlloheni me këtë
dashuri që, këta njerëz e shprehin për vëllanë tuaj.
Ju do të thoni: po, po, po shumë i ri! Jo ai nuk është i
ri, por i pjekun në vullnetin e Zotit. Ai ka jetuar plot
njëzet vjet ma shumë se Krishti. Ju, na keni dhuruar
një vëlla, ai sot po ju dhuron një Kishë!

Shpeshherë, gjatë këtyre ditëve më keni thanë: tani
të kemi vetëm ty! Po do të më keni! Por mos pritni të
bëhem Lucjan. Më lejoni të jem Dodë, sepse do t'ju
mjaftoj për ngushëllimin tuaj.

Vëlla i dashur,
çka të them ty, që më ke përcjellë gjatë gjitha
ditëve të jetës sime, me duresë, dashuri dhe respekt.
Këtu po ndahen rrugët tona. Ti ja mbërrite cakt, e
mua më le prapë shtegtar! Prandaj më duhet të them
një fjalë falenderimi:

- Në radhë të parë, të falenderoj që ke ditë të
jesh mik, mik në fe, mik në dashuri për kishën, mik
në gatishmëri për sakrificë, mik në shërbim baritor,
mik besnik i drejtë dhe i paanshëm.

- Të falenderoj, për dëshminë e mirë që e ke
lanë ngado që ke shku, për qortimet e që gjithnjë m'i
ke përsëritur dhe për gjurmën e fesë që ke lanë në
mua dhe në zemrën e të gjithë këtyre njerëzve që sot

të rrethojnë.

- Të falenderoj, që gjithnjë më ke ndihmuar
të shuaj zemërimin, më ke frenuar për të ngadalësuar
ngutinë, më ke ngushëlluar në dështime dhe më ke
mbështetë në iniciativë.

- Të falenderoj që nuk u trondite kur të
thashë, **"se do të vdesësh"**! Por prapë i fortë thojë:
"nuk më dhimbset vetja por Kisha në Shqipëri".
U bafte vullnesa e Zotit!

Vëlla i dashur, mos të dhimbset as vetja as Kisha
në Shqipëri! ndoshta deri sa lëngoje në shtrat, s'ke
pasë mundësi, por tani jam i sigurt se sheh: që më
shumë ke ungjillëzuar kur sëmundja të detyroj të
heshtësh, se kur predikoje. Janë më të shumtë ata që
të kanë përjetuar në fe sot, se sa kur ishe gjallë ndër
ne. T'kam lakmi për këtë dashuri kaq të madhe që je
duke përjetuar sot, si nga qielli ashtu edhe nga toka.

Ti verbrisht me ke besuar, sepse gjithnjë të
kam thanë të vërteten. Këndej më duhet të rrëfej
se pa të pyetur, ta dhashë Kryqin e Krahavorit
tim që ta marrësh me vete dhe ta mora kryqin
e Krahavorit tënd. Krishti ka qenë ai që na ka
miqësuar dhe e ka rritë miqësinë tonë, **kështu
me shkëmbimin e kryqave "një pjesë e imja
do të varroset me ty por edhe një pjesë e jotja
do të jetoj në mua"**.

Tani pusho në paqe! E lutu për ne!

Fjalimi i dom Simon Kullit me rastin e kalimit në amshim të Imzot Lucjan Avgustini



Besimtarëve të tu o Zot jeta nuk u merret, por
u shndërrohet

Ishin këto fjalët, të marra nga liturgjia e meshës
së salikimit, që më së shumti Bariu i yni i përsëriste
dhe më të cilin ngushëllonte besimtarët në të tilla
raste. Pikërisht, përmes të njëjtave fjalë, duke i
dhënë zë fjalëve të tij, dëshiroj të ngushëlloj secilin
nga ne.

Shkëlqesi të nderuara, bashkëvëllezër të tij
në shugurim ipeshkvor, autoritete qendrore dhe
vendore, familjarë, miq, dashamirë, të afërm dhe
të gjithë ju besimtarë të Dioqezës së Sapës, por
edhe më gjerë, edhe pse në një situatë të tillë,
prapëseprapë na ngushëllon fakti se Ipeshkvi ynë,
gëzoi deri në fund respektin, nderimin, afërsinë
dhe dashurinë e secilit nga ju.

Kisha "humbi" një Bari, Kombi humbi një zë,
familjarët humbën një bir dhe vëlla, dioqeza e jonë,
e Sapës, humbi një prind, një babë. Por, në qiell

kemi një ndërmjetësues të vazhdueshëm.

1. Na shërbeve më shumë se sa të shërbyem.

Fort përzemër e more detyrën e bariut sapo
Selia e Shenjtë Apostolike ta besoi ne vitin 2007. Ta
besuan sepse të njohën. Njohën në ty virtytet dhe
vlerat të cilat kurrë s'u kurseve t'i vije në shërbim
të grigjës. Asnjë vështirësi s'të ndali. Këmbët s'të
pushuan asnjëherë aq sa mbarë territorin e gjerë
e të thepisur të dioqezës e vizitove. Mendja s'të
pushonte. Natë e ditë, në lutje e në bashkëbisedime,
kërkoje ta njihje vullnesën e Zotit mbi delet e tua.
E deshe këtë Dioqezë dhe me bindje mund të them
se erën e secilës dele ja njohe.

Edhe pse ato të çrregullta qeliza vdekjeprurëse
"punonin" pareshtur në kokën tënde, edhe pse në
një gjendje të vështirë, deshe të na mësoje deri në
fund domethënien e saktë të shërbimit. Kremtove
me ne Themelimin e Eukaristisë duke na lënë
ne, meshtarëve të tu, porosinë jetoni të bashkuar

gjithmonë në Krishtin. Ajo meshore (kasul) e vitit
të mëshirës, dhuratë e jotja për meshtarët e tu, sa
herë që do e veshim për kremtime do na tregoj
dashurinë dhe butësinë atërore të treguar ndaj nesh
E kulmove atë të enjte të madhe, të paharruar për
mendjen, në larjen e këmbëve të besimtarëve të
tu më të përzgjedhur. Nga Roma më telefonove
duke më shprehur – sot mund ta pohoj pa frikë –
dëshirën tënde të fundit: atë gjest identifikues të
Kishës, sikurse është larja e këmbëve, ta kryeje me
personat me aftësi ndryshe. Ashtu ndodhi! Tejet u
gëzove! Me dëshmi të fortë na mësove.

2. Na deshe më shumë se sa të deshëm.

Mbi modelin e Bariut të Mirë e themelove dhe
me shumë këmbëngulje e rrënjose shërbesën dhe
veprimtarinë tënde baritore. Kulmi i kësaj dashuri,
ndaj të gjithëve, qe kur ajo zemër e jotja, e vogël
për nga përmasat, por gjerësisht e madhe për nga
prania, hapi mendjet dhe zemrat tona si meshtar,
por edhe të besimtarëve mbarë, kur me forcë deshe
praninë e një shtëpie Bamirësie, palestër të vërtetë
për shpirtin.

3. U dergje por s'u shove ...

Në këto 10 vite të tija si Bari i kësaj grigje,
deshi të njihje çdo njeri, çdo kënd, çdo cep të
territorit. Përshkoj me çdo mjet secilën zonë duke
shkelur, duke përjetuar dhe duke parë realitetin e
besimtarëve të tij, të zonës së tij, me sytë e vet. Si
një bari i mirë, përpara se t'i printe grigjës, deshi të
sprovonte mbi vete rrugët, shtigjet, ujërat, kullotën
ku donte t'i shpinte delet e veta.

Edhe pse sëmundja pikës së pari gllabëroj disa
nga shqisat e kryesore të tuat, prapëseprapë, ajo
gjendje pezulli, në vend që të na dëshpëronte,
na përforconte. Sepse e kishim atë ndjesi të fortë
se edhe pse i pafuqishëm fizikisht, kishe fuqi të
mëdha shpirtërore, apo sikurse vet ti i je shprehur

një murgeshe në një prej ditëve të tua të dhimbjes: **“Edhe trëndafili për të treguar bukurinë e tij pengohet nga gjembat”**. Ky parfum rrezatoi përgjatë 23 netëve poshtë dritares tënde, përballë trupores së Zojës së Lurdit – që aq shumë i devotshëm ishe. E vazhdove apostullimin tënd të bashkimit të grigjës, barinj dhe besimtarë, të vendit apo edhe të dioqezave të tjera.

E tani, në mbarim, në emrin e secilit nga ju dëshiroj publikisht të shprehë ndjenjat e përzemërta të falënderimit për disa persona apo realitete.

1. Së pari një falënderim për Atin e Shenjtë, Papë Françeskun për kujdesin e tij të ngrohtë e atëror që me shume pranim e dëftoi ndaj monsinjorit.

2. Nunin Apostolik, Sh. T. Imzot Moliner Ingles pse na qëndroj pranë nesh duke bashkëndarë me ne shpresën dhe dhimbjen. Për asnjë çast s'na mungoi nxitja, prania dhe këshilla e tij, ndërsa bariu ynë dergjei në shtratin e dhimbjes.

3. Falënderimet janë edhe për Konferencën Ipeshkëvoren të Shqipërisë, për praninë e tyre në vuajtje me bashkëvëllain e tyre.

4. Shkelqesin e Tij, mikun dhe shokun e fëmijërisë, bashkëvëllain në meshtari dhe episkopat Imzot Dod Gjergjin, pse deri në fund i qëndroi pranë.

5. Dom Markun që në ditët e para të semundjes sate të qendronte gjithmonë afër si i birë i dashur dhe besnik në çdo moment deri në fund të fundit.

6. Për ekipin e mjekëve të Repartit të Neurologjisë së Spitalit në Gemelli Romë

7. Për gatishmërinë e pakursyer të Bashkësisë

“Shën Egidio” me në krye udhëheqësin e saj shpirtëror, Presidentin e Këshillit Papnor për Familjen, dhe këtu të pranishëm, Shkelqesin Tij. Imzot Vincenzo Paglia.

8. Provincën e Motrave “Mësueset Venerini” në Romë, më në krye Provincialen Motër Enrikën, pse për shumë ditë shtëpia e tyre u shndërrua në shtëpi kure, mikpritje familjare dhe vëllazërore.

9. Shtëpinë e Kurës të Etërve Orioninë në Romë, që s'kursyen asgjë prej bujarisë së madhe të tyre.

10. Shoqatën “Malteser” në Shqipëri, me drejtues doktor Maranaj, që së bashku me punën e palodhur të tyre i kujdesuan për anën mjekësore. Shërbesa e përkushtuar e imzot Lucjanit si President i kësaj shoqate shihet. Sot gjate meshës na nderon me praninë e tij Udhëheqësi kryesor i ardhur enkas nga Gjermania.

11. Falënderojmë edhe Motrat Vincenciane dhe Françeskane të Zojës së Papërlyer që me aq duresë, përkushti, profesionalizëm dhe shërbim u vunë në gatishmëri.

12. Falënderimet janë edhe për familjarët e ipeshkvit, që edhe një herë tjetër me dinjitet dëshmuuan fenë e tyre, duke jetuar me ne çdo moment të dhimbjes së tij. Humbët një vëlla, por fituar shumë të tjerë.

13. Falënderoj bamirësit e dioqezës, individ dhe institucione, që na u gjetën pranë, me ndihma konkrete, për të përballuar këto momente të vështira.

14. Falënderimet i kemi edhe për Popullin besimtar të Dioqezës, që përmes “armës” më të madhe që si të tillë dispononim “LUTJA” pa pra e pa reshtur u bënë lutje erëmirë që naltohej tek Ati qiellor.

15. Ka shume miq e dashamirë që në forma të ndryshme kanë shprehur ngushëllimet e tyre. Këto telegrame s'mund t'i lexojmë, për efekt kohe, por mjafton t'i përmendim: Bashkësia e San Egidio;

Më lejoni që në fund t'i përmbyll falënderimet duke u qenë shumë mirënjohës meshtarëve, rregulltarëve dhe rregulltareve të dioqezës së Sapës jeni të gjithë të mrekullshëm. Ashtu të mësuar për të qenë të bashkuar, le të vazhdojmë me të njëjtën frymë që na frymëzoi ipeshkvi ynë sa ishte gjallë. Edhe pse pa bari, do dimë të përshkojmë rrugën me të njëjtën shpirt bashkimi dhe vëllazërimi si dhe do pranojmë këdo që Shpirti Shenjtë, përmes Kishës Nënë, do zgjedhë si Bari për dioqezën tone. Mons kerkojme te falur nese ndonje here ta kemi prishur ose ste kemi degjuar, por lutu shume per ne dhe per kishen ne Shiperi.

16. Monsinjon te falenderoj qe ne vitin 1997 gjate trazirave ne Shkoder se bashku edhe me besimet e tjera ti ishe ambasador i paqes, dhe tash e tutje do jesh pellumb i paqes qe fluturon lart dhe sjell paqe ne Shiperi dhe ne boten mbare.

17. Na ke lënë një amanet që në fillimin e vitit te meshires per dioqezen tone te Sapes, Pajtohuni me Hyjin dhe me njeri tjetrin, nje shprehje qe eshte e vendosur ne katedrale. Dioqes e Sapes realizoje kete amanet te bariut tone.

18. Te gjithë ju, me emer e pa emer, qe me menyra te shumta na u gjetet prane dhe e bëtë te mundshme realizimin e këtij kremtimi. Zoti i meshirshem ua shperblefte me të mira! Faleminderit

Bashkudhëtar shtegtimi për vitin e mëshirës 2015-16

vijon nga numri i kaluar


REFLEKTIM

Një hap thelbësor në shtegtimin tonë është vajtja në Rrëfim, kremtimi i Sakramentit të Pajtimit. Kjo kurrë nuk është e lehtë, madje as për ata që shkojnë rregullisht në rrëfim. Ka të bëjë me vajtjen në një gjykim ku peshohen veprimet dhe mënyra jonë e jetesës. Do të thotë të pranosh gabimet, të përballësh me fajet dhe të shohësh pasojat e mëkateve të tua. Askujt nuk i duket gjë e lehtë! Prandaj na duhet shtysë e fortë për të shkuar në Rrëfim. Por kurajo. Kjo është pista kryesore e mëshirës së Hyjit dhe Dera e Mëshirës çon te dera e rrëfyësëtores. Përkohje këtë rrugë! Jepu zemër sidomos atyre që po i kthehen kësaj udhe pas shumë kohësh!

Teksa kapërcejmë Derën e Mëshirës, le t'i kërkojmë Hyjit hirin e pendesës, pasi edhe kjo është vepër e Shpirtit Shenjt. Vetëm ky hir na bën të shohim kthjellët udhën në të cilën Hyji na thërret. Dhe të lutemi që po këtë hir ta marrin edhe ata që e kanë të zorshme ta kërkojnë vetë atë, kushdo qofshin!

LUTJE

Zot,
mesazhi yt i mëshirës dhe paqes
arriftë tek të gjithë këtë Vit Jubilar.
Askush mos e bëftë veshin shurdh ndaj ftesës sate.



*Për hatrin tonë ti e derdhe mbi ne jetën tënde të brendshme,
një jetë dashurie, vërtetësie dhe mëshire,
në vdekjen e Jezusit
dhe në ardhjen e Shpirtit Shenjt.
Bota është plot me lavdinë tënde.
E ajo do të shndërrohet më shumë
nëse jeta jonë do ta pasqyrojë më qartë!
Fali fajet tona.
Na i fal mangësitë ne, Kishës sate,*

*me të cilat eklipsojmë mirësinë tënde të pafund.
Na pastro që të mos e çnderojmë emrin tënd
por vetëm të rrezatojmë
dashurinë dhe mëshirën tënde.*

KAPITULLI 7

MARIA, NËNA E MËSHIRËS PËRMBLEDHJE

*‘Nëna e të Kryqëzuarit dhe e të Ringjallurit
ka hyrë në shenjtëroren e mëshirës hyjnore sepse*

ajo mori pjesë ngushtësisht në misterin e dashurisë' (MV24).

Çdo Kishë Katolike ka një shtatore të Marisë. Ajo është Nëna e ne të gjithëve, që na është dhënë nga i Biri teksa ajo ndodhej poshtë kryqit. Dëshira e saj është na çojë të gjithëve tek Jezusi, sepse ajo, më shumë se kushdo, e di dashurinë e pamatë që Ai ka për ne, atë dashuri që është vetë jeta e Hyjit, Atit, Birit dhe Shpirtit Shenjt.

Papa Françesku shkruan: 'E zgjedhur për të qenë Nëna e Birit të Hyjit, Maria, qysh prej fillimit, u përgatit nga Hyji si Arkë e Besëlidhjes mes Hyjit dhe njeriut. Ajo ndrynte në zemër mëshirë hyjnore në përkim të plotë me Birin e saj Jezus. Himni i lavdit që ajo këndoi në hyrje të shtëpisë së Elizabetës, i kushtohej mëshirës së Hyjit që shtrihet nga "breznia në brezni" (Luka 1:50). Ato fjalë profetike të Virgjëres Mari na përfshijnë edhe ne. Ky është një burim ngushëllimi dhe force tek kalojmë prapun e Vitit të Shenjtë për të përjetuar frytet e mëshirës hyjnore.'

'Poshtë Kryqit, Maria, së bashku me Gjonin, dishepullin e dashurisë, që dëshmitare e faljes së shqiptuar prej Jezusit. Kjo shprehje e epërme mëshire ndaq atyre që e kryqëzuan na tregon deri në ç'pikë mund të arrijë mëshira e Hyjit. Maria jep siguri se mëshira e Birit të Hyjit nuk njeh kufi dhe vlen për këdo, pa përjashtim' (MV24).

Mëshira e Hyjit mund të vërehet me qartësi

të veçantë edhe tek Maria vetë. Ajo është përfutjesja e përkryer e mëshirës së Hyjit sepse ajo i dhurohet krejtësisht ndikimit të kësaj mëshire, shëlbimit tonë. Tek Maria shihet qartë se mëshira i paraprin mëkatit pasi ajo përfitoi plotësinë e mëshirës së Hyjit dhe që gjithnjë pa mëkat. Duke qenë e papërllyer nga mëkati, dëshira e zjarrtë e Hyjit për shpëtimin tonë, mëshira e Hyjit, ia bën atë të madhe zemrën sa kthehet tërësisht në vegël e Hyjit. Tek ne mëkati ka ndikim të kundërt. Mëkati e tkurr gjithçka në dimensionet tona: nocionin që kemi për dashurinë e vërtetë, për nevojat vetjake, për çka konsiderojmë 'të mirë'. Kjo na dëmton dhe kufizon. Mëshira, pavarësisht si mbërrin në zemrat tona, na shpëton. Dhe Maria, 'Nëna e Mëshirës', është gjithnjë e gatshme për të na çuar tek i Biri, gurra e çdo mëshire.

Në Festën e Ngjites së Zojës në Qiell këtë vit, Papa Françesku shkroi në Twitter: 'Jeta e Marisë na tregon se Hyji bën vepra të mëdha me anë të më të përvuajturve!'

REFLEKTIM

Gjatë gjithë këtij udhëtimi shtegtimi, qoftë shtegtim i jashtëm apo udhëtim në thellësinë e shpirtit, jemi në shoqërinë e Marisë. Le ta çmujmë praninë e saj, përqaftimin e saj të përzemërt. Ajo qan me ne. Ajo merr pjesë në gëzimet dhe kënaqësitë tona. Ajo i di përpjekjet dhe vuajtjet tona. Ajo është me të vërtetë Nëna jonë. Çdo çast

është e gatshme të na përsërisë premtimet e Birit të saj të Dashur, plani që ai ka ndërmend për ne, plan që i jep asaj gëzim në zemër dhe neve na e ripërtërin shpresën dhe qëndrueshmërinë. Kur mbajmë në shtëpi ndonjë imazh apo diçka që na e kujton praninë e saj, gjejmë forcë dhe dashuri.

LUTJE

Të falemi Mbretëreshë, Nëna e mëshirës, jeta, ëmbëlsimi e shpresa jonë, të falemi. Ty të thërrasim ne të shkretët bijtë e Evës, që po fshajmë, po gjëmojmë e po qajmë në këtë shekull plot me lot.

Deh pra, Pajtorja jonë, ata sy të mëshirshëm të tu silli prej nesh e Jezusin, të Bekuarin, frytin e barkut tënd, pas kësaj shkretie na e kallëzo, o e dhimbshmja, o e buta, o e ëmbla Virgjëra Mari.

Lutu për ne, o Nëna e Shenjtë e Hyjit, që të bëhemi të denjë për premtimet e Krishtit.

I botuar me lejen e Kardinalit Vincent Nichols dhe shtëpisë botuese Alive Publishing
I përkthyer nga Anila Korbi

- vijon -

Sakramendi i rrëfimit 20 arsye, për mos me shku me u rrëfy!!!

Nga Dom Marjan LUMÇI

vijon nga numri i kaluar

9) E di se do të mëkatnoj përsëri, që do të thotë se nuk jam i penduar.

Mvaret.... pasi kjo që ti mendon dhe shpreh nuk është e vërteta bazë e sakramendit të rrëfimit. Gjëja e vetme që Zoti të kërkon në rrëfimin tënd në këtë moment është që ti të jesh i penduar dhe i keqardhur për mëkatin që ke bërë deri në këtë moment e në të cilin ti po jeton, dhe që ti je i gatshëm që të luftosh mos me e ba ma. Askërkush nuk po të kërkon dhe nuk ka të drejtë me të kërkuar që ti të angazhohesh e të premtosh me betim për të ardhmen që as ti e as kërkush nuk e din por që është dhe mbetet në misterin e Zotit. Çka do të ndodhin mbas një muajit, kush e din? Unë nuk e di. Në rrëfim të kërkohej që me sinqeritet të jesh i vendosur, që në atë moment ta mohosh mëkatin dhe të kesh dëshirë me u larguar prej tij. Të ardhmen duhet ta lësh në dorën e Zotit dhe jo në kthetrat e imagjinatës tënde.

10) Nuk i di mirë rregullat e rrëfimit.

Po, kush të ka thënë se për tu rrëfyer duhet me patjetër të dish rregullat, a thua se Zoti mund të mbërthehet në skemat njerëzore. Rregulli i vetëm është zemra e penduar dhe dëshira për me modeluar jetën sipas dëshirës së Zotit. Ti bëje hapin e dytë duke shkuar dhe duke e kërkuar meshtarin, se hapin e parë e ka bërë vetë Zoti për ty duke ndejtë tash dy mijë vjet e duke të pritë,



e do ta shohësh se nuk ka nevojë për rregulla njerëzore Mëshira Hyjnore.

11) Kam frikë sepse rrëfyestari do të mendojnë keq për mua!

Meshtari nuk është aty për me të gjykuar, por për me të siguruar se Zoti të ka falë. Nëse edhe ai me veten e tij do të mendojnë keq për ty, ky është dhe mbetet problemi i tij dhe i besimit të tij të pakët për të cilin ai vetë duhet të shkojnë dhe të rrëfëhet. Por unë të siguroj se meshtari gjithmonë është i prirur që të mendojnë të mirën: vlerëson

fenë, në kuptimin e besimit tënd (e din se nëse ti je aty për të treguar mëkatet e tua, nuk je aty për atë, por sepse ti beson se ai përfaqëson Zotin për ty në atë vend), beson dhe vlerëson sinqeritetin tënd, beson dhe vlerëson dëshirën tënde për ty përmirësuar dhe për t'ja filluar historisë tënde me Zotin dhe me jetën prej fillimit...

Mbasi ta bësh një eksperiencë të tillë me meshtarin, presupozoj se do ta kuptosh që të ulesh dhe të rrish për orë të tëra duke dëgjuar mëkatet e të tjerëve falas, nuk mund të bëhet nëse nuk ke

një dashuri të theksuar për shpirtrat e njerëzve. Për këtë arsye, nëse meshtari ta kushton kohën ty, nëse është aty duke të dëgjuar me kujdes, e gjithë kjo është sepse ai don për me të ndihmë dhe se ti si shpirt e si njeri je shumë i rëndësishëm për të. Edhe nëse nuk të njeh aspak, ai të vlerëson dhe don për me të ndihmë që edhe ti të bashkohesh me Krishtin që këtu në tokë për ta bërë bashkë me të udhëtimin drejt qiellit.

12) Po sikur meshtari t'ja tregojnë ndokujt tjetër mëkatet e mia?

Vetëm për këtë gjë nuk duhet kurrën e kurrës të kesh ma të voglin marak. Kisha e ka pasë dhe e ka vetë marak këtë punë, saqë në të Drejtën Kanonike parashikon dënimin ma të madh që mund të ekzistojnë për një meshtar - Skomunikimin - mallkimin - përjashtimin prej Urdhnit Meshtarë - për atë meshtar i cili guxon apo gabon dhe e nxjerrë sekretin e rrëfimit, pra sekretin e asaj gjëje apo të atij mëkatit që kushdo besimtar ja beson në rrëfim. Po ti hedhësh një sy të shpejtë historisë së Kishës do të gjejsh meshtarë martirë që kanë vdekë në tortura dhe në asnjë mënyrë nuk kanë pranuar që ta tregojnë një sekret të tillë, edhe atëherë kur nuk bëhej fjalë ndoshta për mëkatet aq të rënda. Pra, pa frikë, një gjë e tillë nuk mund të ndodhin kurrë, sepse çdo meshtar këtë gjë e din mirë dhe e ka parasysh vetë.

13) Çfarë mëkatit kam bërë?

Shpesh herë ndeshemi me një përgjigje të tillë. Unë nuk kam mëkat. Edhe pse thuhet se: «herë me hiri, herë pa hiri, shtatë herë në ditë gabon ma i miri», prapë se prapë «unë nuk kam mëkat!!!». Mesha dhe në mënyrë të veçantë frekuentimi i shpesh të rrëfimit të hapë sytë që jo vetëm ti shohësh por edhe ti njohësh disa sjellje të tuajat të cilat edhe pse ti nuk e din se janë mëkat, në të vërtetë mund të jenë mëkat shumë i rëndë.

Shumë persona kur i pyet se pse nuk janë rrëfyer, e japin një përgjigje të tillë: Po çfarë mëkatit kam ba? Vra, skam vra! Pre, skam pre! Kurvnu, skam kurvnu! A thua se këtu është i gjithë mëkati i njeriut? A thua se, duke bërë thashetheme për të afërmin tënd, ti tashmë nuk po e vret atë? A thua se, duke e lakmuar tjetrin për të keq, ti tashmë nuk je në rrugën e kurvinit shpirtnor e mandej edhe konkret material? Thoshte Pader Gjergj Fishta: «Puna e keqe si po thue, nis curril e bahet prrue». Pra, rrëfimi don me kenë për besimtarin mjeti i cili ndal currilin për mos e ba prrue, don me kenë ilaçi me të cilin shërohen plagët e vogla, para se me u ba varrë të mëdha.

Mandej është edhe diçka tjetër fort e sigurt: nëse nuk e ven veten para pasqyrës plot dritë të rrëfimit dhe vazhdon me jetu me terrin e injorancës së botës, rrezikon mos me dalë në dritë, në dritën e cila të bën të mundur për me e pa me të vërtetë ashtu si është mëkatin tënd. Është sikur të jesh duke ecë natën nëpër terr në një rrugë me baltë e ti ke veshë një kostum të bardhë. Pavarësisht se je bërë me baltë, dhe kostumin e ke bërë pis, asnjë për personave që të rrijnë përreth dhe as ti vetë nuk ke me e vënë re një gjë të tillë. Kjo gjë ka me u pa vetëm atëherë kur të dalësh në dritë. E njëjta gjë është edhe me mëkatin. Derisa je në terr nuk ven re se diçka nuk shkon, por kur ti afrosh dritës dalëngadalë e vëren se kush është e mira e kush është e keqja në jetën tënde morale.

14) Jam dembel.

Kjo mund të jetë e vërtetë, por nuk mendoj se është një pengesë e vërtetë, pasi është një pengesë e cila mendoj se mund të kapërcehet lehtësisht. Nuk besoj se ke ndejtë ndonjëherë një vit pa bërë dush, vetëm sepse je dembel... Trupin e lajmë çdo ditë, mendjes i bëjmë lavash çdo ditë me çdo lloj informacionit të pastër e të pa pastër, sytë i ushqejmë me ç'të na rastisin para tyre dhe nuk i mbylлим ndonjëherë prej dembelisë... ndërsa shpirtit i thojmë: jam dembel me u marrë me ty...

15) Më vjen turp prej mëkateve që kam bërë.

Meshtari me të cilin ti po rrëfesh, shërben si garant i faljes dhe jo si gjykatës i çështjes tënde apo i mëkateve të tua. Ti në rrëfim je sepse shpreh pendim, dhe jo se pret gjykim. Gjykatësi i vetëm i mëkateve të tua, është Zoti, dhe si i tillë, na e ka lanë rrëfimin jo se vend i gjykimit, por si vendi i pajtimit me të. Prandaj, vetëm turpi nuk duhet të eksitojë përballë njeriut meshtar, ndërkohë që aty ti je përballë Atit Zot.

16) Nuk kam kohë.

Nuk besoj se me të vërtetë je i sigurt se në gjashtë muajt fundit e nuk ke gjetë vetëm pak kohë për me shku e me u rrëfye, ndoshta vetëm 10 minuta. Kisha dashtë që të bëjshe një krahasim me orët që ke ndejtë para televizionit, orët që ke ndejtë duke luajtu, orët e humbura në facebook?! Bane një provë e llogaritë ata orë e mandej krahasoi me 10 minutat e rrëfimit, e shihe se sa në disproporcion të tmerrshëm e kë vu shpirtin përballë trupit dhe psikes tënde.

17) Nuk gjej një meshtar!

Meshtarët nuk janë një rracë në rrugën e zhdukjes së tyre ende fatmirësisht. Nëse ti i kërkon mund të gjeshe sa të duash. Kur na intereson me e gjetë një prodhim të fundit të teknologjisë apo modës, nuk lajmë kanal internetit pa kërkuar, derisa mos të biem në kontakt me prodhimin ose firmën që e prodhon atë. Në rastin e meshtarëve «nuk ke ku me i gjetë» sepse nuk don e ndoshta nuk din se ku me i kërku. Shumë prej tyre i gjen edhe në internet, ndoshta jo në eBay apo Amazon, por nëse e vendos emrin e tyre në Google, mbase diçka edhe të del, por, pse me u lodhe me internetin, kërko e gjej një derë kishe të hapur, e me siguri aty ke me e gjetë dikë që të pret. Por... nëse nuk shkon, vështirë se kanë me të ardhë me të kërku. Maksimumi ka me të ardhë ndonjë dëshmitar i jehovait, por aty nuk ta kisha këshilluar me u rrëfye, sepse, pas rrëfimit në vend që me e marrë e me ta ruajt ata sekretin e rrëfimit, e merr ti vetë me vetë, sepse mbase «të mbetet thjesht koha me gjetë një litar», e aty mbaron gjithçka.

18) Është tepër i madh mëkati apo gabimin që kam bërë!

Nuk ka asnjë mëkat që të mund ta tejkalojnë Mëshirën e Zotit.

Zoti i jonë në të cilin na e kemi shpresën, Jezu Krishti, ka vdekë për mëkatet tona, për të gjitha mëkatet tona pa dallim, dhe prej kryqit rrin e pret ndjenjën tonë të pendesës dhe të kthimin. Qysh në Besëlidhjen e Vjetër, përmes gojës së profetit Izaia, Ati shprehet duke thanë: Izaia 1,18 «thotë Zoti: Edhe në kjoshin mëkatet tuaja kuq

si gjaku, do të bëhen bardhë si bora». Pra Zoti pret kthimin tonë, dhe duhet të besojmë se nuk ka gjë të pamujtun për Zotin. Në Besëlidhjen e Re, një prej mëkateve më të rënda të bame prej vetë Apostujve, konsiderohet mohimi që shën Pjetri i bën Krishtit në gjykatore. Pavarësisht se me Krishtin kishte ndejtë tri vjet, me të kishte prediku dhe i kishte pa mrekullitë e Tija, shën Pjetri mohon se e ka takuar ndonjëherë. Vetë Zoti ja paralajmëron këtë mohim me këngën e gjelit. Por shën Pjetri shpreson në Mëshirën Hyjnore dhe nuk dëshpërohet si Juda. E takon Krishtin në ringjallje dhe sikurse për tri herë Pjetri e kishte mohuar, po tri herë Krishti e pyet Pjetrin nëse e don. Pra aq herë sa ne mëkatnojmë, po aq herë Zoti na e jep shansin për me e ndreqë mëkatin tonë. Sa herë që i bijmë mohit, aq herë na e jep mundësinë për me e pohue. Besimtar i mirë nuk është ai që edhe pse rrin në guj, rrin vetëm tue kja e tue i thanë Zotit: O Zot, shih çfarë mëkatit kam ba, por ai që i thotë me trimni mëkatit: «o mëkat, shihe çfarë Zotit kam».

19) Nuk gjej një meshtar të mirë.

Një prej justifikimeve të rëndomta është edhe ky i mos të gjeturit të një meshtarit të mirë e të shejtë, a thua se është meshtari ai që i fal mëkatet e nuk është Zoti autori i vetëm i faljes, ndërsa meshtari mbetet thjeshtë vegla ndërmjetëse që të jep garancinë e faljes.

20) Unë e kam një lidhje me zotin. Pse duhet të rrëfhem me priftin, që të më fali ai në vend të zotit?

Kur mendohet në këtë mënyrë, atëherë nuk është arritë kuptimi i thelbit të rrëfimit. Në rrëfim, Zoti është gjithçka dhe prifti është garanti i faljes që vjen prej Zotit. Prifti të jep garancinë e zgjidhjes së mëkatit tënd: Mateu 16, 15-20; Po ju u tha atyre ç'thoni: kush jam unë? I përgjigji Simon Pjetri: «Ti je Mesia Biri i Hyjit të gjallë!» Atëherë Jezusi i tha: «I lumi ti, o Simon, biri i Jonës, sepse këtë nuk ta zbuloi mishi e gjaku, por Ati im që është në qiell! ¹⁸ Edhe unë po të them: Ti je PjetërShkëmb dhe mbi këtë shkëmb unë do ta ndërtoj Kishën time dhe dyert e ferrit s'do të ngadhënjëjnë kundër saj! Ty do t'i jap çelësat e Mbretërisë së qiellit: gjithçka të lidhësh mbi tokë, do të jetë e lidhur edhe në qiell e gjithçka të zgjidhësh mbi tokë, do të jetë e zgjidhur edhe në qiell.»; Garancinë e faljes së mëkatit tënd: Gjoni 20, 19-23; «Në mbrëmje po të asaj dite të parën ditë të javës ndërsa dyert e shtrëpisë, ku banonin nxënësit, ishin të mbyllura prej frikës së judejve, erdhi Jezusi, zuri vend midis tyre dhe u tha: «Paqja me ju!» Si u tha kështu, u tregoi duart dhe kraharorin. Nxënësit u gëzuan, kur e panë Zotërinë. Mandej u tha prapë: «Paqja me ju! Sikurse më dërgoi mua Ati, ashtu unë po ju dërgoj ju.» Si foli kështu, hukati mbi ta dhe u tha: «Merrni Shpirtin Shejt! Atyre që jua falni mëkatet, u falen, e atyre që nuk jua falni, nuk u falen.»

Pra prifti nuk merr vendin e Zotit, por është vegël ndërmjetëse sipas porosisë së Tij, që ti të sigurosh shpirtërisht se mëkati i jot është i falur dhe se pajtimi i jot me Zotin e me të afërmin është i mundshëm apo edhe është arritë. Pra, rrëfimi, nuk është një sakrament i cili ka zanafillë në tokë nga vullneti njerëzor i drejtuesve të Kishës për ti mbajtur moralisht pastër njerëzit, por ka zanafillë Hyjnore për ta pajtuar njeriun me vetveten në tokë dhe me Krijuesin në qiell.

Jeta e një të burgosuri nën dritëhijen e Udhës së Kryqit

Nga M. Rr

vijon nga numri i kaluar

Por pas ngushëllimit të grave, Jezu Krishti përsëri rrëzohet. Rrëzohet sepse mëkati i njeriut asht tepër i madh, mëkati i jem së bashku me mëkatin e botës rëndon mbi shpatullat e tija. Nga sa di unë, të rrëzohesh tre herë në Bibël do thotë të rrëzohesh pafundësisht, sepse treshi asht një numër i plotë. Atëherë me dhimbje më duhet të pranoj se sa herë që unë bëj një mëkat dhe rrëzohem, aq herë Zoti im ndjen dhimbje për mu dhe rrëzohet bashkë me mua. Pra në këtë ndalesë kur Krishti ngushllon gratë dhe u thotë të kjajnë mëkatet e tyre, edhe unë po numëroja mëkatet e mija. Por Krishti, nën kryq, prapë u rrëzua dhe unë e lashë numërimin e shkova ti ndihmoja. I randë ishte ai kryq e s'mujta me e ngritë. Po, pse valle? Eh budallë, i thashë vedit, Ai s'po mban kryqin e vet. Ai asht kryqi jem, mëkate të medhaja në randojnë!!!

Pas rrëzimit të tretë Jezu Krishtin e zhdeshin. Tek kryqi që po më randonte dhe shpirti filloj të me dhimbte, kur Krishtin po e zhdesnin. Po, pse po e zhdeshin? Për turpet e mija. Po, pse po e gozhdojnë? Për mëkatet e mija. Po, pse po vdes Ai ndërsa unë i kam ba fajet? E ndërkohë ndigjoj prej Kryqit Krishtin që thotë: «Fali, o Atë, se s'dinë ç'ka bajnë». Kto s'diken megjithë mend: unë gaboj e Ai pagun. Kjo nuk asht e drejte.

Teksa e shoh ashtu të zhdeshun, më vjen të bërtas me të madhe: Më zhvish edhe mua, o Zoti, që të dal në të vërtetën teme para vetvetes dhe para botës. Më zhvish që ta shohin të gjithë se nuk jam ai kriminel i përfolur, por biri i yt, që bashkë me ty po heq mundimet e kësaj bote të mbushur plot me lot.

Jezusin e gozhdojnë në kryq. O Zoti im, nuk e di me saktësi se në këtë botë sa herë të kam gozhdu, nuk e di me saktësi se sa herë më kanë gozhdu, por një gja e di me siguri, ato gozhda që ty të mbajnë mbi kryq, janë gjykimet e padrejta të një botë që jo vetëm nuk e len njeriun të pajtohet me vetveten, por nuk don me e leju njeriun as të pajtohet me ty.

Dhe pas një agonie të gjatë Jezu Krishti vdes në kryq. Ky ishte momenti ma i tmerrshëm për Zotin tonë, por për mua që ndjej në shpirt fjalët e fundit të tijat, shndërrohet në një moment ngushëllimi kur ndjej fjalët e Tija të fundit: «Fali, o Atë, se nuk dinë se çfarë po bëjnë». Sa Zoti i mrekullueshëm asht Zoti im në të cilin unë besoj. Në kulmin e një vuajtjeje të pa meritume, Ai, na kupton dhe mirëkupton. Më fal mua, që në çastin e kriminit nuk e dija me të vërtetë se çfarë po bëja, por i fal edhe ata që më gjykojnë mua, sepse në të vërtetë nuk e dinë se çka po bëjnë. Faleminders, o Zoti, që me vdekjen tande i tregove botës se si të pajtohet me ty dhe me vetveten.

E vendosëm Zotin në Kryq. Nuk zgjodhi një fron tjetër për të mbretënu por zgjodhi Kryqin. Më vijnë ndërmend disa fjalë të Padre Pios i cili thoshte se: Hyji don që mjerimi i jonë të jetë fronti i mëshirës së tij, dhe paafësia e jonë të jetë fronti i gjithëpushtetësisë së tij». Dhe me faj i mbushun, shoh Krishtin tek e ulin prej kryqit dhe tek e venjë në prehen të Nanës së vet, më erdh zor me ju afru. Thashë ti kërkoj falje. Po kujt ma parë? Nanës tij? Nanës teme? Apo asaj nane që jetën ja mora? Jezusin e ulin prej kryqit, e ulin prej atij druri në të cilin unë e vura, e ulin për ta vënë në tokën të cilën unë sot po e shkeli, dhe prej së cilës shpresoj të marr mëshirën që vjen nga prekja prej këmbëve të Zotit. dhe menjëherë pas këtij çasti vjen varrosja e të pafajshmit. Eh... varrosja... Dhe tek Jozefi e Nikodemi që po varrosnin Krishtin, me shkoj mendja tek dita e fundit e jemja mbi këtë tokë! Kush do ta bajnë atë? Ndoj punëtor i bashkisë së Krujës, apo im bir? Po çka të më vajtojnë ai mu!? Bemat dhe trimënitë, apo ditët e tij të lumtura e të trishtume që unë s'ju ndodha pranë!

Atë ditë, kjo ditë ishte e premtë, ishte e Premtja e Madhe, ishte e Premtja e Zezë. I Pafajshmi vdiq për mëkatet tona. Sikurse Zoti im e pati një të Premte të Zezë në jetën e tij, ashtu edhe unë, edhe të gjithë ne që jemi të mbyllur brenda hekurave të ftoftë të burgut e kemi pasë dhe e kemi një të Premte të zezë që nuk po din të mbarojë kurrë,

që nuk po din të na largohet për asnjë çast prej mendjes dhe prej zemrës tonë.

Pas mbarimit të Udhës së Kryqit, dom Marjani na thotë se nuk duhet të ndalemi këtu, sepse historia e Zotit nuk përfundon këtu, pasi që Ai, të Dielen e Pashkëve do të ringjallet. Mendja menjëherë më shkoi, edhe pse nuk me shqitet për asnjë çast, tek e Premtja ime e zezë, tek varri që më mban të mbyllur brenda së bashku me viktimat e dorës sime të tmerrshme: A thua me të vërtetë ai varr do të zhduket ndonjë ditë? A thua me të vërtetë do të ma japë Zoti im hirin që të besoj se dhe për mua e për gjithë ka një të Diele Pashkësh, një të Diele Ringjalljeje? Unë shpresoj dhe besoj se po. Jam i sigurt se shpresa në Zotin nuk zhgënjën. Ai vetë na e ka premtuar.

Tek mendoja sa shumë larg Krishtit isha, ky rrugëtim kishte mbaru e dom Marjani po tregonte historinë e njeriut që po i kerkonte Zotit me ja shkurtu kryqin që ja kishte caktu që prej lindjes së tij. E ndërsa historia tregonte se vetëm duke e mbajtur kryqin që jeta na ka dhanë, mund ta kapërcejmë «lumin» për në Parriz, ngritja e Krishtit në qiell filloj të më dobësonte edhe ma shumë. E dija se vetëm afër Tij mund ti fitoja fuqitë dhe fillova ti vë me vërtetësi në kandar të mirat e të këqijat e mija, por hesapet s'po më delshin. Po normal, kjo asht puna e tjetër kujt. Po si ta marr vesht unë se ka anon peshorja? Apo duhet me prit ditën e fundit? Po sikur ta pyes Zotin? Ndoshta më përgjigjet. Me tanë këta «sikur-a» kishte maru dita, por nuk me flihej pa një përgjigje. Isha shumë larg Krishtit e kjo dobësia jeme më kerkonte me ju afru. Po. Kryqi i madh, tha Krishti, kryqi që i asht dhanë secilit në masën që të mund ta bajmë, të ndihmon: e ky kryqi i jem i madh asht sa te dush, ndoshta ma i madh se forcat e mia, por Zoti i jem po më thoshte -jo! Dy shpirta më randojnë!!! Në Parriz unë!!! Hej, i thashë vedit: Ato janë fjalet e Zotit, e Ai e din ma mirë. Mu duk se u lehtësova dhe sapo me zente gjumi, në titrat e televizionit, një shprehje më zunë sytë: «I takon një të forti» të pranojë dobësitë e tij».

